



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit  
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Drejtoria Komunale e Arsimit-Odeljenje za Obrazovanje-Department of Education

Nr. i Protokolit: 04/752  
Data: 08.02.2023  
Rahovec

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.06/L-114, neni 67 dhe 68, neni 5 pika c e Ligjit Nr.03/L-068, për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, neni 37 të Ligjit Nr.04/032 për Arsimin Parauniversitar dhe në harmoni me U.A. të MASHTI-it Nr. 34/2014 Funksionimi i Shërbimit PedagogjiPsikologjik në Shkollë, U.A Nr.26/2013 si dhe në bazë të U.A. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec shpall:

## KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

### 1. Titulli i vendit të punës, Pedagog Shkollor

Institucioni:	Komuna e Rahovecit
Drejtoria:	Drejtoria Komunale e Arsimit
Lloji i pozitës:	Shërbim Publik
Numri i Pozitave:	3 (tri)
Orari i punës:	40 orë në javë
Titulli mbikqyrës:	Drejtori i shkollës
Grada/Koeficienti:	7 (shtatë)
Kohëzgjatja:	1/e karrierës (punë provuese 6 muaj)

Nr.	Titulli i pozitës	Koeficienti	Vendi i punës
1.	Pedagog	7.0	SHFMU "Isa Boletini"
2.	Pedagog	7.0	SHFMU "Bajram Curri"
3.	Pedagog	7.0	SHFMU "Sadedin Hajda"

### Detyrat dhe përgjegjësitë e Pedagogut të shkollës

#### 1. Pedagogu kryen këto punë:

- 1.1. Planifikimin, programimin dhe organizimin e punës edukativo-arsimore;
- 1.2. Mbështetjen e hartimit dhe zbatimit të Planit Zhvillimor të Shkollës;
- 1.3. Koordinimin e punës së aktivave profesionale dhe planprogrameve të mësimdhënësve;
- 1.4. Përkrah klubet e nxënësve, Këshillat e Prindërve dhe organet apo këshillat tjerë në shkollë;
- 1.5. Merrë pjesë në hulumtimin e nevojave arsimore, si dhe në hartimin dhe zbatimin e projekteve shkollore;
- 1.6. Përcjell dhe inkurajon futjen e risive dhe praktikave të mira pedagogjike;
- 1.7. Vepron në realizimin e efektshëm të procesit edukativo-arsimor;
- 1.8. Ndhmon dhe udhëzon mësimdhënësit në realizimin e veprimtarive mësimore, në zbatimin e metodologjive ndërvepruese të mësimdhënies duke promovuar filozofinë me nxënësin në qendër përmes ndihmës për implementimin e nxënies në bashkëpunim, punës me projekte, mësimdhënies së diferencuar, promovimin e çasjes gjithëpërfshirëse si dhe ndihmon dhe udhëzon në përgatitjen e modeleve mësimore, planëve ditore etj.

- 1.9. Përcjell, hulumton, analizon dhe vlerëson punën e shkollës;
- 1.10. Hospiton sistematikisht dhe analizon procesin mësimor, duke hulumtuar dobësitë dhe përparësitë e shkollës, efikasitetin e punës në mësim, raportet mësimdhënës-nxënës, hartimin e raporteve mbi suksesin e nxënësve, disiplinën në klasa, duke inkurajuar vlerësimin e vazhdueshëm të nxënësve, ndihmon mësimdhënësit fillestar, duke monitoruar zbatimin e Kurrikulës;
- 1.11. Bashkëpunon me nxënës, duke identifikuar aftësitë e nxënësve për nisje në klasën e parë, duke u ndihmuar atyre në njohjen e potencialeve të tyre si dhe në socializimin e tyre;
- 1.12. Bashkëpunën me prindër dhe udhëzon ata për pjesëmarrje aktive dhe vendimmarrje në shkollë;
- 1.13. Bashkëpunon me institucione profesionale dhe me komunitetin;
- 1.14. Ndhmon dhe inkurajon punën në zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe zhvillimin profesional të tyre;
- 1.15. Udhëheq dhe përkujdeset për dokumentacionin shkollor;
- 1.16. Bashkëpunon me Psikologun e shkollës në të gjitha çështjet e përbashkëta të këtyre profesioneve, por nëse shkolla nuk ka Psikolog kryen edhe detyra e Psikologut varësisht nga nevojat e shkollës dhe kapacitetet e tij.

#### **Kualifikimi:**

Kandidatët e interesuar për pozitat Pedagog, duhet të kenë përgatitje shkollore të nivelit Master në degën e Pedagogjisë në Fakultetin Filozofik, përkatësisht fakultetin e Edukimit studimet 4 vjeçare në Degën e Pedagogjisë (apo siç është e rregulluar me UA 2014 për licencimin e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve Profesional).

#### **Kushtet për konkurim:**

- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit.
- Shkathtësi këshillimi analitik, vlerësues dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale.
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, EXEL.Powr Point, Access dhe internetit).
- Kopjen e vërtetuar të diplomës (Nostrifikimin, nëse kandidati ka të kryer shkollimin jashtë Kosovës).
- Dëshmi mbi përvojën e punës.
- Dëshmi mbi trajnimet profesionale.
- Ekstraktin e lindjes.
- Kopje të dokumenteve prsonale (letërnjoftim ose pasaportë).
- Certifikatën mbi gjendjen shëndetësore.
- Certifikatën që nuk jeni i dënuar apo nën hetime.

## Informata të përgjithshme:

- Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes.
- Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet mund ti marrin në kopje fizike në Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA) apo t'i shkarkojnë nga portali shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net> dhe të plotësuara t'i dorëzojnë në DKA në Rahovec.
- Dokumentet prahen nga data 10.03.2023 deri me datë, 24.03.2023, deri në ora 15.00.
- Vetëm Kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe hyjnë në listën e ngushtë do të ftohen në intervist me shkrim.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk prahen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.
- Intervistimi me shkrim i kandidatëve bëhet më datën 30.03.2023 në ora 10 në zyrat e DKA-së në Rahovec.
- Vetëm kandidatët që grumbullojnë më shumë se 59 pikë nga testi me shkrim do të ftohen në intervistim me gojë.
- Intervistimi me gojë do të realizohet me datë, 10.04.2023.

Avni Morina, Drejtor

